

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

MBLEDHJA E SEANCËS PLENARE

Mbledhja e dytë e Kuvendit të Kosovës u mbajt me 13.12.2001.

Mbledhjen e hapi kryetari i zgjedhur i Kuvendit të Kosovës z.Nexhat Daci i cili lajmëroi se Rrendi i ditës do të jet vazhdimi i seancës së kaluar dhe ftoi përfaqësuesit e PDK-së të emërojnë dy kandidatët për anëtarë të kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Mirëpo përfaqësuesi i grupit politik të PDK lajmëroj se edhe në këtë mbledhje nuk i kan të gatshëm emrat.

Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës

Në emër të LDK-së Nekibe Kelmendi emëroj Ibrahim Rugoven si kandidat për kryetar të Kosovës dhe lexoj biografinë e tijë.

Në emër të PDK-së foli Jakup Krasniqi i cili tha se partija e tijë ishte për bashkpunim por nuk pajtohet me votimin e sotshëm për kryetar të Kosovës dhe se nuk do të marrin pjesë në votime.

Në emër të KK Rada Trajković theksoj se Kualicioni Kthimi për shkak të rregullave të procedurës do të votoj por fletat e votimit do të jen të zbrazta.

Pas disa diakutimeve të deputetëve z.Daci ftoj deputetët të votojnë për kandidatin e vetëm të propozuar për kryetar të Kosovës nga LDK z Ibrahim Rugova.

Pas votimit fletvotimet u kontrolluan nga shërbimi juridik i Kuvendit dhe përfaqësuesit e këtyre partive politike : LDK,PDK,AAK,KP,VATAN,LPK.

Pas kontrollit u shpallën këto rrezultate:

- 118 – deputet të pranishëm**
- 80 – shumica e nevojshme**
- 70 – deputet votuan**
- 49 – votime për**
- 21 – votime të pa vlefshme**

Pasi që nuk u arritën votat e nevojshme nuk u bë zgjedhja e kryetarit të Kosovës dhe z.Nexhat Daci ndërpreu mbledhjen duke thënë se deputetët do të njoftohen për mbledhjen e ardhshme.

SHËRBIMI JURIDIK I KUVENDIT

13.12.2001
PRISHTINË